



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika c dhe nenit 40, paragrafi 40.2, pika a të Ligjit nr. 03/L – 040, dt. 20.02.2008, për Vetëqeverisje Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/2008), neneve 22 dhe 23 të Ligjit nr. 04/L-110, dt. 31.05.2012, për Ndërtim (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 18/2012), neneve 14 dhe 17 të Ligjit nr. 03/L - 049, për Financat e Pushtetit Lokal, dhe të nenit 34, paragrafi 34.1, pika c e Statutit të Komunës së Prishtinës, nr. 01-110-391, dt. 25.02.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 30.11.2023, miratoi këtë:

RREGULLORE
PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES
MBI TAKSËN ADMINISTRATIVE PËR DHËNIEN E LEJES SË NDËRTIMIT DHE
TARIFËN PËR RREGULLIMIN E INFRASTRUKTURËS 01-434/01-0094474/17 dt.
24.04.2017

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është plotësimi dhe ndryshimi i Rregullores mbi taksën administrative për dhënie e lejes së ndërtimit dhe tarifën për rregullimin e infrastrukturës 01-434/01-0094474/17.

Neni 2
Teksti i nenit 13 i rregullores ndryshohet si vijon:

Mënyra dhe afatet e pagesës

13.1. Pagesa e taksës administrative për dhënie e lejes së ndërtimit, tarifës rregulluese për rritjen e densitetit të infrastrukturës dhe tarifës rregulluese me ndikim të drejtpërdrejtë në infrastrukturë sipas kësaj rregulloreje, bëhet në tërësi përnjëherësh.

13.2. Rrjedhja e afatit për pagesën e taksës dhe tarifës, sipas nenit 2, paragrafi 13.1 të kësaj rregulloreje, fillon ditën e parë pas marrjes në dorëzim të aktvendimit, marrëveshjes për llogaritjen e taksës dhe tarifës përkatëse, si dhe nuk mund të jetë më e gjatë se pesëmbëdhjetë (15) ditë për kategorinë e I-rë të ndërtimit, dhe tridhjetë (30) ditë për kategorinë e II-të të ndërtimit, nga dita e pranimit të Aktvendimit dhe Marrëveshjes.

13.3. Vendimi për lejen e ndërtimit nuk mund të jepet në dorëzim pa provën mbi pagesën e taksës administrative, tarifës për ndikimin e densitetit në infrastrukturë dhe tarifës rregullative të infrastrukturës.

13.4. Nëse pagesa e kompensimit të llogaritur nuk bëhet brenda afatit të paraparë sipas paragrafit 13.2 të këtij neni, kërkesa për dhënien e lejes së ndërtimit do të refuzohet nga organi kompetent.

13.5. Rishqyrtimi dhe ushtrimi i mjeteve juridike administrative në kundër të Aktvendimit dhe Marrëveshjes, sipas kësaj rregulloreje nuk e shtyn afatin për pagesë të paraparë në paragrafin 13.2, e as nuk i ndalon veprimet e organit kompetent të parapara me nenin 2 të kësaj rregulloreje.

13.6. Për aplikuesin të cilit iu refuzohet kërkesa për leje të ndërtimit, taksa administrative nuk kthehet, pasi që organi kompetent krijon shpenzime për shqyrtim të po kësaj kërkesë.

13.7. Aplikuesit të cilit i është refuzuar kërkesa për leje të ndërtimit, dhe që ka paguar tarifën rregulluese për rritjen e densitetit të infrastrukturës dhe tarifën rregulluese me ndikim të drejtpërdrejt në infrastrukturë, i kthehen mjetet e paguara, pas parashtrimit të kërkesës për kthim të atyre mjeteve, te organi kompetent, përveç në rastet kur verifikohet që i njëjti ka realizuar ndërtimin pa u pajisur me leje të ndërtimit.

Neni 3

Teksti i nenit 14 i rregullores, ndryshohet dhe plotësohet, si vijon:

14.1 Nga pagesa e taksës dhe tarifës lirohen kategoritë, si në vijim:

- a) Ndërtimet të cilat financohen nga Buxheti i Kosovës;
- b) Ndërtimet të cilat financohen përmes donacioneve ose granteve për interes publik në pajtim me legjislacionin në fuqi për menaxhimin e financave publike;
- c) Ndërtimet për banim individual për përfituesit e skemës së ndihmës sociale, të cilët paraqesin kartelën e ndihmës sociale të vlefshme;
- d) Rindërtimet e ndërtimeve të shkatërruara si rezultat i luftës, trazirave shoqërore ose forcës madhore.

14.2 Nga pagesa e taksës dhe tarifës, lirohen edhe të gjitha kategoritë tjera të përcaktuara me ligje të veçanta, me qëllim të zgjidhjes së çështjes së banimit.

14.3 Për lirim nga tarifa dhe taksa e përcaktuar, sipas paragrafit 14.1 dhe 14.2, duhet të prezantohen dëshmi nga institucionet përkatëse.

Neni 4
Dispozitat kalimtare

1. Procedurat administrative që janë në shqyrtim sipas kërkesave për pajisje me leje të ndërtimit, të cilat janë të pranuar deri në datën e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, do të vazhdojnë të trajtohen sipas dispozitave të rregullores, të cilat kanë qenë të aplikueshme deri në hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje.
2. Të gjitha kërkesat e reja për pajisje me leje të ndërtimit, të cilat pranohen nga data e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, do të trajtohen në pajtim me dispozitat e kësaj rregulloreje.

Neni 5
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-434/01-227572/23, më 01.12.2023

KRYESUES I KUVENDIT
Pëllumb Bajcinovci

